

**NË UNIBA
FILLON
SË SHPEJTI**

BAZAT E MENAXHIMIT TË BIZNESIT

Synimet e trajnimeve

Bazat e Menaxhimit është një trajnim hyrje në menaxhim që synon të pajis pjesëmarrësit me mjetet thelbësore të kërkuara nga menaxherët e sotëm efektivë. TRajnimi kombinon informacionin teorik me aplikimet praktike. Pjesëmarrësit mund të përdorin përvojat e tyre, të hulumtojnë informacione dhe të zbatojnë njohuritë e tyre në situata tipike të menaxhimit të ditëve të sotme.

Një ndër synimet kryesore të këtij trajnimi është të zhvillojë aftësitë e buta të pjesëmarrësve, si, komunikimin, zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen, negocimin, planifikimin dhe organizimin, menaxhimin e kohës, lehtësimin dhe koordinimin. Gjithashtu pjesëmarrësit do të trajnohen edhe në aftësitë e nevojshme teknike për të menaxhuar në sipërmarrje, aftësi të tilla si, përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave; përgatitja e parashikimeve dhe buxheteve; përdorimi i mjeteve të planifikimit dhe organizimit; mbajtja e shënimeve; hartimi i planeve të trajnimit dhe zhvillimit, listat kontrolluese procedural, iniciativa për shpërblimin e stafit si dhe zhvillimin e strategjive.

Qëllimi i trajnimit: Të ndihmojë pjesëmarrësit të mësojnë rreth përgjegjësisë themelore të një pozicioni menaxherial.

Përmbajtja e programit të trajnimit

- Koncepti i Menaxhimit; Nivelet e Menaxhimit; Stilet e Menaxhimit; Mjetet e Menaxhimit dhe Menaxhimi i Diversitetit
- Procesi i Planifikimit dhe Organizimit; Mjetet e planifikimit dhe organizimit
- Procesi i zgjidhjes së problemeve; Procesi i Vendimmarrjes; Aftësitë negociuese
- Udhëheqja në mënyrë efektive; Lehtësuese; Koordinuese
- Komunikimi efektiv; Takime dhe diskutime në grup
- Kuptimi i menaxhimit të kohës; Përmirësimi i Menaxhimit të Kohës
- Motivimi; Siguria në punë; Shëndeti në punë

Garancia e programit të trajnimit



- Trainerë të kualifikuar
- Programe modern të përshtatura me praktikën e punës konkrete
- Zhvillim aftësisë lidhur me rritjen e shanseve për punësim
- Trajnim dual mes koncepteve teorike dhe zbatimit të tyre praktik
- Nxitja e iniciativave sipërmarrëse me projekte në fund të kurseve për komercializim

Kush ka të drejtë të aplikojë

- Njerëz të biznesit të cilët janë në një pozicion drejtues ose që planifikojnë të jenë në të ardhmen.
- Njerëz të cilët kanë pasion menaxhimin dhe sipërmarrjen.
- Menaxher të sipërmarrjeve të vogla
- Nuk kërkohet përvojë të mëparshme.

Kohëzgjatja dhe mënyra e zhvillimit

- Kohëzgjatja 21 orë efektive.

Mundësitë e punësimit dhe karriera

- Ka mundësi të punojë si menaxher në biznese të ndryshme
- Të zhvillojë një sipërmarrje të re për ta drejtuar dhe menaxhuar atë

Certifikimi

Certifikatë formimi profesional e licensuar dhe akredituar.



#ejanëUniBa

Organizimi i trajnimit:
Fleksibël

Vendi i zhvillimit të trajnimit:
BTTCC – Universiteti Barleti

**Fillojmë së shpejti
Rezervo vendin tënd**

+355 697063488
bttc.mng@umb.edu.al
bttc.umb.edu.al/
 Tiranë, Rruga Frang Bardhi, Selitë

